



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 07, datë 24.11.2021

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKUALIFIKIM URBAN I PARKUT ARKEOLOGJIK TË DURRËSIT”,
BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit, Ministrisë së Kulturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Rikualifikim urban i Parkut Arkeologjik të Durrësit”, Bashkia Durrës, me zhvillues Ministrinë e Kulturës.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I KULTURËS

ELVA MARGARITI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

